



NEON A.S  
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005  
TIRANA, ALBANIA  
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770  
E-MAIL: [info@neon.al](mailto:info@neon.al) WEB: [www.neon.al](http://www.neon.al)

---

**NEON BOJAK PLLAKASH  
( STUKO AKRILIKE PER PLLAKA QERAMIKE )**

Skedë Teknike

---

**PËRSHKRIMI:** NEON BOJAK PLLAKASH për fuga është një material ndërtimi dekorativ i cili bën të mundur thithjen e turrje – bymimeve të nënshtresës dhe të pllakës qeramike.  
NEON BOJAK PLLAKASH përbëhet nga një përzierje rezinash akrilike speciale, materialesh inerte me bazë silikate dhe përbërje kokrrizore konstante, çimento të standarteve të larta si edhe aditivë e shtesa të tjera të cilët përmirësojnë vetitë e tij. Falë cilësisë së zgjedhur të komponentëve të tij, NEON BOJAK PLLAKASH është i vetmi që ofrohet për stukime nga 1 – 10 mm dhe paralelisht ka rezultate të shkëlqyera në lidhje me papërshkueshmërinë nga uji, dhe aftësinë ngjitëse. Disponohet në 25 ngjyra moderne të cilat e theksojnë estetikën e pllakave, si edhe mund të kombinohen me njëra – tjetrën për të përftuar nuanca të tjera sipas dëshirës së konsumatorit.

**FUSHA E PËRDORIMIT:** NEON BOJAK PLLAKASH ofrohet për stukime të çdo lloji pllakash, për mjedise të jashtme dhe të brendëshme. Në mjedise që u nënshtrohen lodhjeve të mëdha dhe lagështisë së vazhdueshme (pishina, tarraca, veranda) rekomandohet shtesë emulsioni akrilik NEON për papërshkueshmëri nga uji. Kur nevojitet aftësi elastike më e lartë, NEON BOJAK PLLAKASH mund të përzieret me rrëshirën akrilike elastike NEON duke dhënë rezultate të mahnitshme psh në dysheme me sistem ngrohjeje që kalon nën to, tarraca e veranda lindore etj.

**NGJYRA:** NEON BOJAK PLLAKASH janë të një game të madhe ngjyrash, të cilat jepen në katalogun e Kompanisë “NEON”, si edhe mund të kombinohen me njëra – tjetrën për të përftuar nuanca të tjera sipas dëshirës së konsumatorit.

**PËRDORIMI:** a) **Përgatitja e fugave:** para se të stukohen fugat duhet të jenë të pastra. Rekomandohet lagia uniforme e tyre (veçanërisht në temperatura të larta) duke evituar mbledhjen e ujërave brenda në fuga. Stukime me NEON BOJAK PLLAKASH mund të bëhet pas 10 – 12 orësh për pllaka që u vendosen ngjitëse dhe pas 7 – 10 ditësh për pllaka që u vendoset llaç.

b) **Përgatitja e materialit:** Përziejme 2 kg pluhur me 0.6 kg ujë ose 5 kg pluhur me 1.5 kg ujë të pastër deri sa të krijohet një masë homogjene pa kokrriza. Përzierja më e mirë bëhet me turiele elektrike me rrotullime të ulta. Pas homogjenizimit të materialit nuk rekomandohet shtesë uji. Përzierja mbetet e

punueshme për 3 orë. Materiali shtrohet me spatul prej llastiku me drejtim diagonal me pllakat dhe ngjishet në fuga deri sa të mos shfaqen boshllëqe. Kur stukoja e humbet plasticitetin e saj dhe bëhet e verbët është momenti i përshtatshëm të lëmojmë sipërfaqen e saj me sfungjer të njomë. Së fundi, vetëm pasi materiali të bëhet relativisht i fortë përdoret një copë pëlhurë e butë për të kompletuar procesin e pastrimit.

**KONSUMI:** Konsumi i NEON BOJAK PLLAKASH varet nga gjërësia dhe thellësia e fugës. Katalogët natyralë të ngjyrave për stukon akrilike NEON gjenden në dyqanet e shitjes së produkteve të saj. Nuanca ekzakte në fugë krijohet pasi kalojnë 24 orë dhe asnjëherë nëse stukoja është e njomë.  
Konsumi i stukos varion nga 500 – 900 gr / m<sup>2</sup> pllaka.

**KUJDES:** Nuk rekomandohet aplikimi i NEON BOJAK PLLAKASH në temperatura nën 5°C dhe mbi 35°C në kombinim me ekspozimin vertikal të pllakave në diell.  
Pas përfundimit të stukimit paisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

#### **TE DHENAT TEKNIKE:**

- Ngjyra..... 25 nuanca me mundësi përzierjeje.
- Gati për t'u shkelur..... pas 4 orësh.
- Temperatura e zbatimit .....+ 5°C deri në + 35°C.
- Rezistenca në temperaturë ..... nga - 30 °C deri në 80°C.
- Papërshkueshmëria në ujë..... shumë e mirë.
- Rezistenca kundër ngricës, lagështisë..... shumë e mirë.
- Rezistenca kundër acideve..... e mirë.
- Rezistenca kundër vjetërimit..... shumë e mirë.
- Rezistenca në shtypje .....100 kg/ cm<sup>2</sup> në 2 ditë dhe 320 kg/ cm<sup>2</sup> në 28 ditë.

**REZIKSHMËRIA:** NEON BOJAK PLLAKASH kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC.

**AMBALAZHIMI:** Ambalazhimi bëhet në qese 2 kg dhe 5 kg.

**KUSHTET E RUAJTJES:** Në ambalazh të mbyllur hermetikisht, të mbrojtur nga ngrica.